



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

VARIANTI **A**

E mërkurë, 1 qershor 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi natyror

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në dramë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	8c	9	10a	10b
Pikët													
Kërkesa	11a	11b	11c	12	13	14	15	16	17	18	19	20a	20b
Pikët													
Kërkesa	21a	21b	21c	22a	22b	23	24	25a	25b	25c	25d		
Pikët													

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Ernest Koliqi****Kërcimtarja e Dukagjinit
(fragment)**

Fragmenti i mëposhtëm sjell atmosferën e prozës së Koliqit. Jemi në çastin kur Lulja, vajzë nga një familje e njohur shqiptare, vallëzon në festën e organizuar nga prijësi i vendit, Skënderbeu. Lexoni me vëmendje si përshkruhet kërcimi magjik i vajzës dhe përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Si u këshillue me bajloza, Mbreti dau me i a dhanë çmimin e premtuem tyrkinës së panjohun e ishte kah jepte urdhën të shpallej ky vendim, kur një kërcimtare e papritun e ndaloi tue dalë në mes të shtrojës.

Ishte princeshë Lulja, mbesa e Lekë Dukagjinit.

Si u ba? Ça ndodhi?

Porsa hyrija malsore çoi duert e luejti kambët, një habi e ambël kapi gjith shpirtnat. Nëpër tanë salonin u ndie si një amë lulësh mali e si një gurgullim krojesh të ngrita.

Sy njeriu s'kishte pa as valle ma të mrekullueshme as kërcimtare ma të bukur. Lëkura e fytyrës së saj gjante e endun me rreze e fletëza prilli. Trupi i vërgjilët përhapte anë për anë një njomsi si lule qi sa po ka çelë.

Të gjithve i u bante se shifshin rreth saj tue lulzue e tue u shfletëzue, si n'andërr, lulishta madhshtore. Ishte një apotheozë lulësh: lule të denduna të panjehuna i u çelshin nën kambët e lehta, reshëshin mbi flokë të lëshuem, dridheshin ndërmjet gishtave të bardhë, derdheshin mbi trup hyjnuer.

Tash gjante si t'ish tue luejtë foshnjisht me përfytyrimin e saj në pasqyrën e një uji të kulluet; mbandej dukej të këputte rremtha të lulzue, tue u ngritë maje gishtave të vogjël. Herë ngitte nëpër shtroje si të ndiqte ndonji flutur ari; herë valavitej si t'a perkundte jehu i një jonës së largët qi ngjallë malle të paprituna.

Merrte m'u ngjitun nëpër një shkallë ajrore, largonte gjeth e lule të padukshme qi i a ndalojshin hovin, hidhej përpara si të biente zhyt në ndonji krue, shtrinte dorën me kapë shoqe tjera e sillej me mënyrën e asaj qi u prin një vargu të gjatë vajzash kërcyese.

E drejtë si curril uji gufues, e lakueshme si gem i njomë, e shpejtë, si hije reje, e dridhshme si drita në krue, endej shpejt, kadalë, hovshëm, pritueshëm. Kërcimi i saj ishte i freskët si liriya e maleve, i lehtë si kind flamuri qi valon ndër maje t'epira, i egër si fluturimi i shqipeve, i përmallshëm si kangë e harrueme qi ngjallet në fund të zemrës.

Sa mbaroi, një brohori e përgjithshme e emnoi mbretneshë të kërcimtareve. Mbreti vetë erdhi m'e marrë për dore. Princat, kapidanat, bajlozat, bujarët, kalorsit, e rrethuen tue e mbulue me lavde e tue i ngjitë mbiemna të bukur.

- Zana me flatra!

- Hyjneshë e kërcimit!

- Dritë hane në prrue!

- Fillad fluturues!

- Lule n'erë! Flutura e Shqipnis;

Bajlozi i Venedikut i pëshpëriti:

- Tersicore!

E ama, Zoga, me çudin ma të madhe qi mund t'i shprehte fytyra, u lëshue kah ajo:

- Po kush të ka mësue, moj, ty me kërcye ashtu?

Për pyetjet 1-6 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Në këtë prozë Koliqi trajton: **1 pikë**

- A) gëzimin e jetës mbushur me gjallëri dhe magji.
- B) pesimizmin si pasojë e shqetësimeve dhe ambicieve njerëzore.
- C) përpjekjen e njeriut për të shijuar bukuritë e natyrës.
- D) elemente biografike nga jeta e tij.

2. Cili është elementi përrallor që futi Koliqi në këtë prozë? **1 pikë**

- A) Festa e organizuar nga prijësi.
- B) Mahnitja e pjesëmarrësve.
- C) Dhënia e çmimit.
- D) Lulja merr trajtat e një Zane.

3. Variantet dialektore *tue lulzue*, *tue shfletëzue* janë: **1 pikë**

- A) folje në mënyrën lidhore.
- B) forma të pashtjelluara të foljes.
- C) shprehje frazeologjike.
- D) shprehje ndajfoljore.

4. Pikën kulmore të kërcimit në këtë fragment e shënon çasti kur: **1 pikë**

- A) Lulja hyn në skenë në mënyrë të papritur.
- B) mësohet që vajza është mbesa e Lekë Dukagjinit.
- C) kërcimi i Lules fiton cilësi gati hyjnore.
- D) Lulja u buzëqesh të gjithë atyre që e mbuluan me lavde.

5. Tek shprehja karakterizuese për Lulen: *Flutura e Shqipnis!* është përdorur figura e: **1 pikë**

- A) antitezës
- B) metaforës
- C) ironisë
- D) alegorisë

6. Koliqi me prozën e tij konsiderohet si: **1 pikë**

- A) vazhdues i traditës së deriatëhershme të prozës shqipe.
- B) themelues i romanit shqiptar.
- C) themelues i tregimit dhe i novelës moderne shqipe.
- D) themelues i prozës publicistike.

7. Identifikoni, në krye të këtij fragmenti, *ngjarjen që pritet të ndodhë* dhe zbuloni *detajin* që pengon zhvillimin e mëtejshëm të saj. **2 pikë**

a) ngjarja: _____

b) detaji: _____

8. Ndaluni në paragrafin e dytë.

a) Cilat janë dy tipare të Lules që shkaktojnë mahnitje? **2 pikë**

b) Gjeneroni një similitudë (krahasim të zgjatur), që autori ka përdorur për të karakterizuar Lulën dhe kërcimin e saj. **1 pikë**

c) Shpjegoni rolin e përcaktorit të nënvizuar në fjalinë: “*Porsa hyrija malsore çoi duert e luejti kambët, një habi e ambël kapi gjithë shpirtmat...*” **1 pikë**

9. Në ç’ vetë është rrëfimi në këtë tregim? Çfarë i ofron rrëfimi në këtë vetë lexuesit? **2 pikë**

a) _____

b) _____

10. Veçoni dy mbiemra në paragrafin e tretë dhe zbërtheni rolin e tyre të përbashkët artistik.

a) mbiemrat: _____ **2 pikë**

b) roli i tyre: _____ **1 pikë**

11. Ndaluni në reagimin e personazheve në fund të fragmentit.

a) Jepni një karakteristikë të këtij reagimi. _____ **1 pikë**

b) Ç’ figurë të sintaksës poetike ka përdorur autori në fjalitë vijuese?
 “Mbreti vetë erdhi m’e marrë për dore. Princat, kapidanat, bajlozat, bujarët, kalorsit,
 e rrethuen tue e mbulue me ladve...” **1 pikë**

c) Pse nëna habitet njësoj si të tjerët? **1 pikë**

12. Shpjegoni si shfaqen në këtë fragment veprimi dhe përjetimi i personazheve, si veçori e stilit të Koliqit. **2 pikë**

PJESA II**ESKILI****Koeforet
(fragment)****Episodi i tretë****Egisti**

Më thirrën që të vija dhe ja, erdha
 Se ca shtegtarë thonë sollën një lajm
 Aspak të mirë: vdekjen e Orestit.
 Tia shtosh barrën e rëndë përmbi supe
 Këtij pallati që kaq plagë ka
 Nga vdekjet e përparshme, është e tmerrshme
 Por pik' së pari duhet të marr vesh
 A është e saktë kjo, apo s'është tjetër
 Veç thashetheme grash nga ato që fryhen
 E treten po aq shpejt, pa asnjë bazë.
 Diçka të sigurt ti a mund të thuash?

Korifeja

Ne lajmin e dëgjuam, por ti hyr
 Gjithçka ta marrësh vesh nga goja e tyre.
 Asnjë kasnec kaq mirë këtë s'e bën.

Egisti

Do ta shoh vetë shtegtarin e ta pyes:
 E pa me syt' e tij tek hiqte shpirt
 Apo mos flet me ç'ka dëgjuar turbull?
 Unë kam nuhatje, nuk gabohem lehtë.
(Hyn në pallat)

Kori

Zeus, o Zeus lutjen time si ta filloj
 Mes zjarrmisë së lutjeve vall si t'i gjej
 Ato fjalë që duhen për ty atje lart?
 Ora e vdekjes ja, ra. Shpata e mortjes u ngrit.
 Maja e saj ngjyer gjak shpatën tjetër kërkon:
 Ose fisi i Atridëve shuhet sot përgjithmonë
 Ose zjarrin në vatër do ndezë prapë heroi,
 Dhe në fron të pallatit të hypë triumfues

Tok me lirinë, sovran legjitim.
 Ja kështu do të ndeshet i pavdekshmi Orest
 Si atleti sfidant ndaj fituesve të parë
 Një me dy veç do ndeshet! O Zeus, fitoftë!

Zëri i Egistit

(Nga brenda pallatit)

Ah, ah, më prenë!

Kori

Ç'qe kjo klithmë? Ky zë?
 Brenda mureve vallë gjithçka mori fund?

Korifeja

Mënjanë le të hiqemi
 Mos thonë që gisht
 Kemi ne tek kjo vrasje!
 Ndeshja mbaroi!

(Kori hiqet mënjanë. Nga porta qendrore e pallatit del me vrap një shërbëtor që drejtohet nga porta e grave dhe troket gjithë alarm).

Shërbëtori

Bobo, bobo! E vranë, e vranë timzot.
 Bobo, për herë të tretë: Egisti s'rron
 Hapeni shpejt! I hiqni llozet portës!
 Një trim për ndihmë duhet, por çë do?
 Të vdekurin më dot nuk e ndihmon!
 O i mjeri unë! Të shurdhëve u thërras,
 Të gjithë flenë, po bërtas më kot!
 Ku është Klitemnestra, vallë ç'bën?
 Me ç' duket, do të bjerë, zverk i saj
 nën shpatë, ashtu siç ra qafë e tim zot.

(Nga porta e gynecut (dhoma e grave) del Klitemnestra)

Për pyetjet 13-19 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

- 13. Koeforet është vepër e gjinisë:** **1 pikë**
- A) epike
 - B) lirike
 - C) dramatike
 - D) epiko-lirike
- 14. Kadare e quan Eskilin:** **1 pikë**
- A) humbës të madh
 - B) humanist të madh
 - C) komediani i parë
 - D) tregimtari modern
- 15. Koeforet konsiderohet një vepër me intensitet të ngritur, sepse:** **1 pikë**
- A) personazhet janë interesantë
 - B) ka ngjarje të panjohura
 - C) ka kuptim të dyfishtë
 - D) pritet të kryhet një krim i pazakontë
- 16. Tema qendrore e kësaj vepre dhe e mbarë trilogjisë, është ajo e fatit:** **1 pikë**
- A) tragjik të fisit, mallkuar nga perënditë.
 - B) të lumtur të fisit, uruar nga perënditë.
 - C) të individit, të pavaruar nga fati fisnor.
 - D) të individit, të pavarur nga ndikimi i perëndive.
- 17. Mendimi i Egistit për lajmin e marrë: *Aspak të mirë...*, lidhet me faktin që:** **1 pikë**
- A) kjo është vrasja e parë në pallat.
 - B) Klitemnestra kërkon të vrasë Egistin.
 - C) Egisti dëshiron të shohë përsëri Orestin.
 - D) po shtohen vrasjet në pallat.
- 18. Fjala “*thashetheme*” është:** **1 pikë**
- A) e parme
 - B) e prejardhur
 - C) e përngjitur
 - D) e përbërë
- 19. Vargu që tregon se vrasja tashmë ka ndodhur, është:** **1 pikë**
- A) Hapeni shpejt! I hiqni llozet portës!
 - B) Të vdekurin më dot nuk e ndihmon!
 - C) Ku është Klitemnestra, vallë ç'bën?
 - D) Të gjithë flenë, po bërtas më kot!

20. Zbuloni dy detaje në fjalët e Egistit, që tregojnë natyrën mosbesuese të tij dhe shpjegoni se nga buron ky mosbesim.

a) detajet: _____ **2 pikë**

b) shpjegimi: _____ **1 pikë**

21. Lexoni vargjet:

Ose fisi i Atridëve shuhet sot përgjithmonë

Ose zjarrin në vatër do ndezë prapë heroi.

Gjeni fjalët antonimike dhe shpjegoni funksionin e tyre në lidhje me problemin e së drejtës. Zbërtheni nëntekstin që mbart shprehja *zjarri në vatër*.

a) fjalët antonimike: _____ **1 pikë**

b) funksioni: _____ **1 pikë**

c) nënteksti: _____ **1 pikë**

22. Tregoni dy vrasjet e kryera më parë në familjen e Atridëve, nisur nga vargjet: “*Këtij pallati që kaq plagë ka/Nga vdekjet e përparshme, është e tmerrshme...*”

a) _____ **2 pikë**

b) Përshkruani gjendjen psikologjike të Egistit po në këtë moment. **1 pikë**

23. Veçoni pasthirmën në fragmentin e fundit dhe tregoni ç’rol luan përsëritja e saj. **2 pikë**

a) _____

b) _____

24. Analizoni rolin e korit në këtë fragment. Pse ai me fjalën e tij i drejtohet Zeusit? **2 pikë**
